

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[09.07.2018]

Për: **“G.P.G. COMPANY & GARDEN LINE”**
Lagjia 18 Tetori, godina 1 kateshe, tek nyja e prodhimit Asfalto – Betonit, Lushnje

Procedura e prokurimit: Pune/ **Procedure e Hapur**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-69600-05-17-2018.**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Ndertim By Pass Tepelene, Loti 1”** me fondin limit 2 394 360 362.35 lekë pa TVSH., (dy miliard e treqind e netedhjetë e katër milion e treqind e gjashtedhjetë mijë e treqind e gjashtedhjetë e dy presje tridhjetë e pesë) leke pa tvsh. Afati i zbatimit të kontratës 22 muaj.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve 21.05.2018] [Nr.20]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. AGBES KONSTRUKSION K32807432W

Vlera 2 394 225 010.96 (dy miliard e treqind e nentëdhjetë e katër milion e dyqind e njetë e pesë mijë e dhjetë pik nentëdhjetë e gjashtë) Lekë pa përfshirë vlerën e tvsh-së.

2. G.P.G Kompani & Garden Line shpk J64324443V / K11427004I

Vlera 2 389 686 891 (dy miliard e treqind e tetedhjetë e nente milion e gjashtëqind e tetedhjetë e gjashtë mijë e teteqind e nentëdhjetë e një) Lekë pa përfshirë vlerën e tvsh-së.

3. ALBSTAR J62903512W

Vlera 2 392 191 541.29 (dy miliard e treqind e nentëdhjetë e dy milion e njëqind e nentëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzetë e një pik njëzetë e netë) Lekë pa përfshirë vlerën e tvsh-së.

4. VELLEZRIT HYSA K12911201C

Vlera 0 (zero) Lekë pa përfshirë vlerën e tvsh-së.

5. VARAKU E J61902509S

Vlera 0 (zero) Lekë pa përfshirë vlerën e tvsh-së.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1	AGBES KONSTRUKSION	K32807432W
2	ALBSTAR	J62903512W
3	VELLEZRIT HYSA	K12911201C
4	VARAKU E	J61902509S

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Operatori ekonomik **“Agbes Konstruksion shpk**, nuk ka paraqitur dokumentacionin në përputhje me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit, sepse:
 - Sipas dokumentacionit të paraqitur rezulton që operatori ekonomik **Agbes Konstruksion shpk**, nuk plotëson kriterin 2.3.3. lidhur me kategoritë e mëposhtme të licencës profesionale për ekzekutimin e punëve: *NP - 9/F Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime; NP – 12/G Punime të inxhinierisë së mjedisit; NS – 8/G Ndërtim parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri; NS – 9/G Punime strukturore speciale.*
 - Sipas vërtetimit të paraqitur nga Operatori Ekonomik mbi xhiron financiare vjetore për TVSH, e realizuar përkatësisht në tre vitet e fundit 2015, 2016 dhe 2017, rezulton se është më e vogël se 1 170 000 000 për vitin 2016 dhe 2017, kjo në kundërshtim me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit.
 - Sipas dokumentacionit të paraqitur rezulton që operatori ekonomik nuk plotëson kriterin 2.3.1. pasi nuk ka punë të ngjashme për një objekt të vetëm (ku të përfshihen ura ose viadukte) në vlerë jo më të vogël se 1 170 000 000 lekë që është realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit ose punë të ngjashme, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 4 600 000 000 lekë.

- Ne vërtetimin e paraqitur që konfirmon shlyerjen e pagesave të energjisë elektrike, rezulton që subjekti në kundërshtim me piken 1/e, të kriterëve të veçanta për kualifikim nuk ka shlyer detyrimet të maturuara të energjisë elektrike të muajit prill 2018. (Mbi detyrimet e maturuara sipas Vendimit të ERE-s, Nr.109, datë 21.10.2011, “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljare, neni 9/1, *Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.*”)
- 2. Operatori ekonomik Albstar sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentacionin në përputhje me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit, sepse:
 - Sipas dokumentacionit të paraqitur rezulton që operatori ekonomik **Alb - Star shpk**, nuk plotëson kriterin 2.3.3. lidhur me kategoritë e mëposhtme të licencës profesionale për ekzekutimin e punëve: *NP - 9/F Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime; NS – 9/G Punime strukturore speciale*
 - Nuk ka paraqitur vërtetimin që konfirmon shlyerjen e pagesave të energjisë elektrike, sipas pikës 1/e, të kriterëve të veçanta për kualifikim, mbi detyrimet të maturuara të energjisë elektrike të muajit prill 2018. (Mbi detyrimet e maturuara sipas Vendimit të ERE-s, Nr.109, datë 21.10.2011, “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljare, neni 9/1, periudhen e kerkuar).
- 3. Operatori ekonomik **Varaku E shpk**, nuk ka paraqitur dokumentacion për pjesëmarrje në këtë procedurë prokurimi.
- 4. Operatori ekonomik **Vellezrit Hysa shpk**, nuk ka paraqitur dokumentacion për pjesëmarrje në këtë procedurë prokurimi.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e operatoreve “**G.P.G Kompani & Garden Line**” me adresë “*Lagjia 18 Tetori, godina 1 katshe, tek nyja e prodhimit Asfalto – Betonit, Lushnje* . së oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **2 389 686 891** (dy miliard e treqind e tetëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e një)*lekë pa tvsh/pikët totale të marra* [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Autoritetit Rrugor Shqiptar/ Sektori i Prokurimeve] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet siguri i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera perkatese e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 29.06.2018

Ankesa: Nuk ka

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____